

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **(213/27400-26-3625-2-2-1)**

Sa i përket tenderit për **Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP.STUDIO LINKS 4

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sool Sopi Kula A/ Lok/10

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

045 555 985

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Nafije Gashi Ademi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

links.projekt@yahoo.com

(Adresa elektronike)

17.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Me date 18.05.2026 eshte shpallur Njoftimi per Kontrate nga AK “Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale” “Procedura e Hapur” dhe kriteri i dhënies “Tenderi i ekonomiksht më i favorshëm ne te cilen Hapja e Tenderit eshte parapare me 19.06.2026.

Me date 06.06.2026 ne si OE kemi parashtruar kerkesen per rishqyrim

Me date 09.06.2026 kemi pranuar pergjigjen per refuzim të kërkesës nga AK.

Ankesa e paraqitur eshte per LOT 1, LOT 2 dhe LOT 3

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

-

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Me date 06.06.2026 ne si OE kemi parashtruar kerkesen per rishqyrtim prane AK dhe me date 09.06.2026 kemi pranuar Vendimim mbi Refuzimin e keresesn nga AK lidhur me kerkesen per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Neni 7 i LPP-së

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik. 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një

procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim

2. Neni 69 i LPP-së

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen

Në procedurat që shpjen në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkojnë lidhur me shkathësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:

4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;

4.2. listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

3. Udhëzuesi Operativ Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, Kapitulli IV – Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së), faqe 29-30.
4. Rregullore 001/2022 për prokurimin publik neni 56.6

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pika 1. Kritere jo ne përputhje me Neni 69

Kriteri 9.1 & 9.2 në DT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”,

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale -deshmia e kerkuar:

- 1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat e realizuara me përvojë në mbikqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe renovuese, ku përfshihen edhe masat EE në 3 vitet e fundit (dëshmi se paku 3 projekte/ndertesa) ku për secilën kontratë të specifikohet data e përfunduar, lloji i shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës. Shuma totale e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë duhet të jetë jo më pak se LOT 1 - 61,500.00 euro , LOT 2 - 52,500.00 euro , LOT 3 - 45,000.00 euro.*

Dëshmi me shkrim (Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave)..

Ne lidhje me “Dëshmi me shkrim” ne si OE kemi bere pyetje sqaruese se a mund te perdoret si deshmi edhe dokumenti i quajtur “Konfirmim/vertetim” i lëshuar nga vet AK?

Interpretimi i kriterit nga AK (bashkangjitur) është : ju sqarojmë se është kërkuar REFERENCA dhe nuk ka një dokument tjetër që e zëvendëson si të tillë, d.m.th. REFERENCA nuk i nënkupton edhe dokumentet e cekura nga ana juaj, të quajtura si Vërtetime ose Konfirmime!

Vlerësojmë se ky interpretim nuk është në përputhje me nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me Udhëzuesin Operativ të KRPP-së.

Neni 69 përcakton se për kontratat e realizuara për autoritete publike, dëshmi e realizimit të kontratës shërben dokumenti i lëshuar nga autoriteti publik. Ndërsa

Udhëzuesi Operativ i KRPP-së interpreton Neni 69 të LPP kështu: *Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimit/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.*

Nga kjo rezulton se legjislacioni nuk e kushtëzon pranueshmërinë e dokumentit me emërtimin e tij, por me përmbajtjen dhe faktin që ai dëshmon realizimin e kontratës.

Në praktikë, shumë kontrata të shërbimeve përmbillen me konfirmime, vërtetime apo dokumente të ngjashme zyrtare dhe jo domosdoshmërisht me dokumente të titulluara "Referencë". Për këtë arsye, refuzimi i tyre vetëm për shkak të emërtimit formal nuk ndikon në vërtetimin e përvojës profesionale, por kufizon pa nevojë mundësinë e operatorëve ekonomikë për të dëshmuar përvojën e tyre.

Për pasojë, refuzimi i tyre vetëm për shkak të emërtimit formal paraqet formalizëm të tepëruar dhe kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Veçanërisht problematik është fakti se vetë FKEE ka lëshuar dokumente të titulluara "Konfirmim" dhe "Vërtetim" si dëshmi të realizimit të kontratave, ndërsa tani pretendon se të njëjtat dokumente nuk janë të mjaftueshme për dëshmimin e përvojës profesionale. Ky veprim cenon sigurinë juridike dhe pritet legjitime të operatorëve ekonomikë për të pasur një dokument valid për të dëshmuar kontratën. Për më tepër, AK pretendon se referenca shërben për vlerësimin e performancës profesionale të operatorit ekonomik. Megjithatë, në rastin konkret për LINKS 4, nuk ekziston asnjë vlerësim negativ i performancës, asnjë paralajmërim, asnjë penalitet kontraktual, asnjë raport moskonformiteti dhe asnjë dokument tjetër që do të vinte në dyshim realizimin e kontratës. Përkundrazi, kontrata është realizuar, pranuar dhe është lëshuar dokument zyrtar që konfirmon përmbushjen e obligimeve kontraktuale (bashkangjitur dëshmi 1 - Konfirmimi për realizim të kontratës të cilin AK tani nuk e pranon). Për më tepër ka OE të cilëve për të njëjtën kontratë por Lot tjetër i është lëshuar referenca madje ende pa përfunduar kontratën. (bashkangjitur dëshmi 2). Prandaj besojmë se AK nuk po i trajton të gjithë OE njësoj.

Përgjigja e AK-së ndaj pretendimit ankimor_1

** AK përgjigjet duke thënë se legjislacioni i prokurimit publik nuk e kufizon Autoritetin Kontraktues që të kërkojë dokumente specifike dhe forma të caktuara të dëshmimit, për aq kohë sa ato kërkesa janë objektive, proporcionale dhe të aplikuara në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.*

AK vlerëson se referenca, si dokument i kërkuar në FDT, ka natyrë dhe përmbajtje specifike, pasi përmes saj jo vetëm konfirmohet ekzistenca e kontratës, por gjithashtu vlerësohet cilësia e performancës, realizimi profesional i shërbimeve dhe përmbushja e obligimeve kontraktuale nga operatori ekonomik. Ndërsa dokumentet e titulluara si "Konfirmim" apo "Vërtetim" mund të përmbajnë vetëm elemente deklarative ose administrative mbi ekzistimin apo përfundimin formal të kontratës, pa përmbajtur domosdoshmërisht elementet e vlerësimit profesional që kërkohen nga AK

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimi i OE-së nuk ka bazë ligjore dhe kërkesa për rishqyrtim në këtë pjesë refuzohet si e pabazuar.

****Koment ndaj Vendimit të AK-së:**

Autoriteti Kontraktues e justifikon kërkesën për "Referencë" duke pretenduar se ajo shërben për vlerësimin e performancës profesionale. Megjithatë, Dosja e Tenderit kriteri 9.1&9.2 nuk kërkon dëshmi të performancës, por dëshmi të përvojës së operatorit ekonomik. Përvoja dëshmohet me realizimin e kontratave të ngjashme, ndërsa AK nuk ka identifikuar asnjë dispozitë ligjore apo kërkesë të FDT-së që kushtëzon dëshmimin e përvojës me një dokument që përmban vlerësim të performancës. Për më tepër, AK nuk ka dëshmuar se dokumentet "Konfirmim" apo "Vërtetim" të lëshuara nga autoritetet publike nuk përmbajnë informacion të mjaftueshëm për të vërtetuar realizimin e kontratës dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuale por spekulon duke thënë **"mund"** te mos përmbajne.

Në këtë mënyrë, AK po shton pas publikimit të FDT-së një element të ri kualifikues ("performancën"), i cili nuk është paraparë në kriterin fillestar për "përvojë të dëshmuar".

Autoriteti Kontraktues nuk ka treguar asnjë dispozitë të LPP-së, Rregullores së Prokurimit Publik apo Udhëzuesve të KRPP-së që përcakton se përvoja profesionale mund të dëshmohet vetëm me një dokument të titulluar "Referencë". I vetmi argument i AK-së është se kjo kërkesë është vendosur në Dosjen e Tenderit. AK pergjigjet se kriteret jane te aplikuara njesoj per krejt OE por vet si AK ka leshuar "reference" per pune ende te paperfunduar per kontraten e njejte nje OE tjeter, prandaj eshte kriter enkas diskriminues dhe kufizues.

*****Interpretimi i KRPP me nr. KRPP-DRR-15-06-90/2026**

Ankuesi i është drejtuar KRPP-së për sqarim lidhur me interpretimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullores së Prokurimit Publik në raport me dokumentet që dëshmojnë realizimin e kontratave.

Në shkresën e saj, KRPP fillimisht sqaron se Autoriteti Kontraktues ka kompetencë të përcaktojë kriteret, kushtet dhe dëshmitë e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Megjithatë, KRPP thekson se kjo kompetencë duhet të ushtrohet në përputhje me dispozitat e LPP-së, respektivisht me nenet 65-70 të LPP-së, dhe se Autoriteti Kontraktues nuk duhet të vendosë kritere që tejkalojnë ose bien ndesh me këto dispozita.

Pikërisht për këtë arsye, KRPP vazhdon me interpretimin e neneve 65-70 të LPP-së dhe sqaron se në këto dispozita nuk përmendet "Referenca" si formë e vetme e dëshmimit të realizimit të kënaqshëm të kontratës. Përkundrazi, KRPP sqaron se realizimi i kontratës mund të dëshmohet me raportin përfundimtar të kryerjes së punëve, certifikatën për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projektit dhe dokumente të tjera relevante që dëshmojnë realizimin e kontratës.

Ky interpretim është veçanërisht i rëndësishëm në rastin konkret, pasi Ankuesi nuk posedon dokument të titulluar "Referencë", jo për shkak të mungesës së përvojës

apo mosrealizimit të kontratës, por sepse vetë Autoriteti Kontraktues, pas përfundimit të kontratës, ka lëshuar dokument zyrtar të titulluar "Konfirmim" si dëshmi të realizimit dhe përmbushjes së obligimeve kontraktuale.

Prandaj, edhe pse kjo shkresë nuk ka qenë në dispozicion të AK-së gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ajo përbën interpretim zyrtar të organit rregullativ të prokurimit publik dhe mbështet qëndrimin e Ankuesit se legjislacioni fokusohet në dëshmimin e realizimit të kontratës dhe jo në posedimin ekskluziv të një dokumenti të titulluar "Referencë".

Por KRPP I referohet edhe pyetjes sqarues nr.10 e cila është publike në faqen e KRPP-se e cila ka këte sqarim: *(i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë-nënshkrura nga autoriteti i tillë publik:*

Pika 2. Kritere joproporcionale dhe që zvoglojnë konkurrencen

Kriteri 9.1 & 9.2 në DT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale",

Në Dosjen e Tenderit, perseri tek seksioni "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale", kërkohet: Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave)

Lidhur me sqarimin e publikuar nga Autoriteti Kontraktues, ku është deklaruar se lidhëza "DHE" nënkupton paraqitjen e detyrueshme të kontratës, certifikatës së pranimit teknik dhe referencës për secilën kontratë, konsiderojmë se një kërkesë e tillë është e panevojshme dhe tepër kufizuese. Kjo për arsye se të gjitha këto dokumente shërbejnë për të dëshmuar të njëjtin fakt, përkatësisht se kontrata është realizuar me sukses. Nëse realizimi i kontratës tashmë dëshmohet përmes kontratës dhe një dokumenti zyrtar të lëshuar nga autoriteti publik, si referencë, konfirmim, vërtetim apo certifikatë pranimit, atëherë kërkimi i dokumenteve shtesë që dëshmojnë të njëjtën gjë nuk sjell ndonjë vlerë shtesë në vlerësimin e përvojës profesionale. Përkundrazi, krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe kufizon konkurrencën, veçanërisht kur vetë Autoriteti Kontraktues ka pasur praktikë të lëshojë "Konfirmime" dhe "Vërtetime" në vend të referencave.

Përgjigja e AK-së ndaj pretendimit ankimor_2

** Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si të pabazuar. AK sqaron se lidhëza "DHE" është përdorur qëllimisht dhe kërkon dorëzimin kumulativ të kontratës, certifikatës së pranimit teknik dhe referencës. Sipas AK-së, secili dokument ka funksion të ndryshëm juridik dhe administrativ:*

kontrata dëshmon ekzistimin e marrëdhënies kontraktuale; certifikata e pranimit teknik dëshmon pranimin formal të shërbimeve; ndërsa referenca dëshmon performancën dhe realizimin profesional të kontratës.

Në bazë të nenit 69 të LPP-së, AK ka të drejtë diskrecionale të kërkojë nivelin e dokumentimit që e konsideron të nevojshëm dhe proporcional.

****Koment ndaj Vendimit të AK-së:**

*Edhe pse Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtë diskrecionale për të përcaktuar dokumentet e nevojshme për dëshmimin e përvojës profesionale, kjo e drejtë nuk nënkupton mundësinë për të vendosur kërkesa **pa bazë ligjore** apo pa arsytuar proporcionalitetin e tyre. AK nuk ka treguar se në cilën dispozitë të Nenit 69 të LPP-së apo të Udhëzuesit Operativ Nr. 002/2024 mbështetet kërkesa për paraqitjen kumulative të kontratës, certifikatës së pranimit teknik dhe referencës për të njëjtën kontratë.*

Pika 3. Zbatim jo i njëtrajtshëm i kriterëve për dëshmimin e përvojës

Kriteri 9.1 & 9.2 në DT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”,

*2.Për të dëshmuar kualifikimet dhe përvojën e stafit të angazhuar, për secilin anëtar të ekipit duke përfshirë menaxherin e projektit, përvojat e kërkuara duhet të dëshmohen me dokumentet përkatëse (CV, kontratë, **vërtetim referencë** nga punëdhënësi sipas kontratave të ofruara), kurse shkollimi të dëshmohet përmes diplomave dhe certifikatave përkatëse).*

Lidhur me kërkesën për dëshmimin e përvojës së stafit, vërehet një mospërputhje në vetë kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Për dëshmimin e përvojës së stafit kërkohet që përvoja të dëshmohet përmes “**vërtetimit/referencës** nga punëdhënësi”, çka nënkupton se Autoriteti Kontraktues i konsideron të pranueshme të dyja format e dokumentimit. Ndërsa për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik, në sqarimet e publikuara është deklaruar se “Konfirmimet” dhe “Vërtetimet” nuk konsiderohen dokumente ekuivalente me referencën.

Nuk është e qartë pse për të njëjtin qëllim tek i njëjti seksion i FDT, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” , pra për dëshmimin e përvojës së mëparshme, Autoriteti Kontraktues aplikon standarde të ndryshme për piken 1 te kërkeses dhe për piken 2 te kërkeses. Ne te njëjtin seksion standard i ndryshem.

Për pasojë, pranimi i vërtetimeve për dëshmimin e përvojës së stafit, ndërsa refuzimi i tyre për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik, krijon një trajtim jo të njëtrajtshëm të kërkesave për dëshmimin e përvojës dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

Përgjigja e AK-së ndaj pretendimit ankimor_3

** Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si të pabazuar dhe të mbështetur në interpretim të gabuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit. AK konkludon se përvoja e operatorit ekonomik dhe përvoja e stafit përfaqësojnë kategori të ndryshme të kualifikimit, pasi përvoja e operatorit lidhet me kapacitetin institucional dhe organizativ për realizimin e kontratës, ndërsa përvoja e stafit lidhet me kapacitetin individual profesional të personave të angazhuar. Për këtë arsye, sipas AK-së, është e ligjshme që për këto kategori të kërkohen forma të ndryshme të dëshmimit, ku për stafin pranohen referencat ose vërtetimet nga punëdhënësi, ndërsa për operatorin ekonomik kërkohet*

dokumentim më i zgjeruar dhe më formal i realizimit të kontratave.

****Koment ndaj Vendimit të AK-së:**

Ankuesi nuk e konteston faktin se përvoja e operatorit ekonomik dhe përvoja e stafit janë kategori të ndryshme të kualifikimi. Megjithatë, duke qene mbrenda te njejtit kriter, AK nuk ka arsyetuar pse një vërtetim i lëshuar nga një autoritet publik apo punëdhënës konsiderohet dokument i besueshëm për dëshmimin e përvojës së stafit, ndërsa një konfirmim apo vërtetim i ngjashëm nuk konsiderohet i pranueshëm për dëshmimin e realizimit të kontratave nga operatori ekonomik.

Pika 4. Buxhet i pamjaftueshem per te realizuar kerkesat sipas TeR

Duke marrë parasysh numrin e ekspertëve të kërkuar, kualifikimet minimale, përvojën e kërkuar, si dhe detyrat dhe angazhimet e përcaktuara në Termat e Referencës, vlera e kontratës duket e pamjaftueshme në raport me kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh nivelin e pagës minimale në fuqi dhe rritjen e saj në 500 € nga 1 korriku 2026.

Për më tepër, sipas nenit 56.6 të Rregullores Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues obligohet që gjatë zhvillimit të vlerësimit të kostos dhe përcaktimit të buxhetit të sigurojë që vlera e parashikuar e kontratës të jetë reale dhe e mjaftueshme për realizimin e kërkesave të kontratës.

Bazuar në kërkesat në Terma te rferencës, duhet të bëhen inspektime dy herë në javë për secilën ndërtesë . Lot 3 përfshinë lokacionin në Karacevë dhe Klinë e Decan e që kjo nënkupton se nuk mund të vizitohen brenda një dite të gjitha lokacionet. Prandaj dy vizita në javë për secilin objekt sipas TeR nënkupton 4 ditë në javë punë në terren. Shto kësaj raportimin në FKEE i bjen që angazhimi të jetë i rregulltë me 5 ditë në javë. Tabela me poshte e sqaron kete:

| | viti 1 | | |
|-----------|-----------|--------------|---------|
| stafi | angazhimi | pagesa | 12 muaj |
| Menaxheri | plote | 1000 | 12000 |
| staf 1 | gjysem | 500/minimale | 6000 |
| staf 2 | gjysem | 500/minimale | 6000 |
| staf3 | gjysem | 500/minimale | 6000 |
| staf 4 | gjysem | 500/minimale | 6000 |
| | | | 36000 |

Kontrata parasheh kohezgjatje te puneve prej 2 viteve.

Në rastin konkret, ekziston dyshimi i arsyeshëm se buxheti i paraparë nuk është në përpjesëtim me nivelin e ekspertizës dhe angazhimeve të kërkuara në Termat e Referencës, prandaj kërkojmë që kjo çështje të rishqyrtohet.

Përgjigja e AK-së ndaj pretendimit ankimor_4

**Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si tërësisht të pabazuar si në aspektin juridik ashtu edhe në aspektin faktik . AK pergjigjet se vlera e kontratës është përcaktuar në përputhje me nenin 56 të Rregullores Nr. 001/2022, duke u bazuar në analizën e tregut, kontrata të ngjashme, nevojat e projektit dhe planifikimin buxhetor. Sipas AK-së operatorët ekonomikë gëzojnë autonomi të plotë në organizimin e burimeve njerëzore, strukturën e kostove dhe realizimin e kontratës. AK vlerëson se kërkesat e TeR-it dhe vlera e kontratës janë të zbatueshme dhe proporcionale, ndërsa OE nuk ka paraqitur prova objektive që dëshmojnë pamundësinë e realizimit të kontratës apo kundërligjshmërinë e buxhetit të parashikuar.*

****Koment ndaj Vendimit të AK-së:**

*AK pergjigjet se mënyra e organizimit të stafit është çështje e operatorit ekonomik. Megjithatë, autonomia e operatorit ekonomik nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nëse përmbushja e kërkesave minimale të Termave të Referencës kërkon angazhim të rregullt të stafit, atëherë operatori ekonomik mbetet i obliguar të respektojë dispozitat ligjore për **pagën minimale dhe të drejtat e punësimit**. Te gjitha ligjet e Kosoves jane te barazvlefshme dhe çdo inspektorat i punes do te penalizonte OE nese angazhon staf ne kundershtim me Ligjin e Punes.*

Duke marrw nw konsideratw tw gjitha faktet dhe argumentet e lartwcekura, kwrkojmw nga OSHP qw pas shqyrimitt tw kwsaj ankese tw nxjerr kwtw:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE **NNP.STUDIO LINKS 4**
- II. **TË BËHET KORRIGJIMI** i Dosjes se Tenderit dhe Kriereve sipas dispozitave ligjore të LPP-së pa shkelur konkurencen dhe pa anuar ne OE te posacem respektivisht tw vendset pranimi i dokumenteve te cilat i ka leshuar vet AK qofshin ato konfirmime/vertetime apo edhe Referenca per OE te posaqem.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si OE rrezikojme të përjashtohemi nga procedura e prokurimit jo për shkak të mungesës së përvojës profesionale, por për shkak të një interpretimi formal nga vet AK të dokumentacionit të kërkuar. Si pasojë, na pamundësohet pjesëmarrja dhe konkurrimi i barabartë në këtë aktivitet të prokurimit, duke shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë material duke filluar nga tarifa ne OSHP dhe dem moral duke kufizuar konkurrencën efektive ndërmjet operatorëve ekonomik per perfitime individuale.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) B05 Njoftimi per kontrate.*
- b) Informata sqaruese*
- c) F02 Kerkese per rishqyrtim te vendimit te AK*
- d) Vendim -Pergjigje nga AK i Kerkese per rishqyrtim*
- e) Interpretimi KRPP*
- f) Prove 1-Konfirmimi per realizimin e kontrates*
- g) Prove 2 – Reference e nje OE per te njejten kontrate por Lot tjetër*
- h) Tarifa e OSHP.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

NJOFTIM PËR KONTRATË

 PUNË FURNIZIM SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 20.05.2026

| | |
|-----------------|-------------------------|
| Nr i Prokurimit | 213/27400-26-3625-2-2-1 |
| Nr i brendshëm | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|--------------------|---------------------------|
| Emri zyrtar: FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË | | |
| Adresa Postare: Luan Haradinaj ish Banka e Lublanes kati i VII | | |
| Qyteti: Prishtinë | Kodi postar: 10000 | Vendi: Kosovë |
| Personi kontaktues: Adem Spahiu | | Telefoni: +383 3820030842 |
| Email: prokurimi@fkee-rks.net | | Faksi: |
| Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://fkee-rks.net/ | | |

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

| <input type="checkbox"/> Punë | <input type="checkbox"/> Furnizime | <input checked="" type="checkbox"/> Shërbime |
|---|---|--|
| <input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | <input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Republika e Kosovës, Gjakovë, Pejë, Klinë, Kamenicë dhe Deçan.

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Kontrate publike kornizë me disa operator

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

74000000-9

II.1.7) Variantet pranohenPo Jo **II.1.8) Ndarja në Pjesë**Po Jo *Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)* vetëm një pjesë Të gjitha pjesët**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)**

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|-----------------|--|--|
| Grupi 1. | Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 1 | Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 1 |
| Grupi 2. | Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 2 | Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 2 |
| Grupi 3. | Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 3 | Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 3 |

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 106,000.00**

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Kompania Konsulente do të jetë përgjegjëse për rishikimet e nevojshme dhe procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të punimeve renovuese me masat EE në ndërtesat përkatëse publike komunale. Procesi i mbikëqyrjes do të përfshijë sigurimin e cilësisë së punëve në përputhshmëri me specifikimet teknike, dizajnit, standardeve të aplikueshme, dinamikës së aprovuar dhe obligimeve tjera, të cilat derivojnë nga kontrakta. Kompania Konsulente do të jetë e angazhuar në LOT-in përkatës, ndërtesat e së cilës do jenë në lokacione komuna të ndryshme të Republikës në Kosovës pavarësisht madhësisë së tyre, sipas përshkrimit të më poshtëm. Kjo kontratë do të jetë kornizë dhe obligimi kontraktual do të varet nga kryerja e shërbimeve, dhe paguhet vetëm për shërbimet e kryera, sipas planit të pagesave pjesë e dokumentit. Kjo shpallet në dosjen e tenderit dhe përfshihet në kontratë.

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **36** apo ditë (nga dhënia e kontratës)

apo

Fillimi

Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Sigurimi i Ekzekutimit të tenderit duhet të jetë i lëshuar nga një bankë me reputacion e licencuar nga BQK në Kosovë. % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata (nëse aplikohet):

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po Jo

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshëm:

1. Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi pranueshmërinë bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042. , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L- 068 dhe ligjin Nr. 05 L-0921. Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi pranueshmërinë bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042. , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L- 068 dhe ligjin Nr. 05 L-092

2. Vërtetim nga Administrata Tatimore e

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit - Aneksi2 -Origjinal

2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata

| | |
|--|---|
| Kosovës. | Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës (vlen për OE fitues para publikimit të Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues) |
| 3. Vërtetim nga Gjykata | 3.Një vërtetim nga “regjistrin gjyqësor” duke iu referuar nenit 65, paragrafi 3, nenparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (vlen për OE fitues para publikimit të Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues)- original ose kopje e noterizuar. |
| III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të OE me të cilin evidentohet regjistrimi i OE në atë vend. (Kopja e certifikatës së biznesit) |
| 2. Certifikata e TVSH-së. | 2. Certifikata e TVSH-së kopje |
| III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1. Deklaratat tatimore vjetore për tre vite 2021-2023.- Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë në vlerë të përgjithshme prej së paku Për Lot 1- 82,000.00 Euro Lot 2- 70,000.00 Euro Lot 3- 60,000.00 Euro | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Deklaratat Tatimore Vjetore të lëshuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, për 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë të përgjithshme prej së paku Lot 1- 82,000.00 Euro Lot 2- 70,000.00 Euro Lot 3- 60,000.00 Euro. |
| III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë ka përvojë të dëshmuar në mbikqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe renovuese, ku përfshihen edhe masat EE në 3 vitet e fundit (dëshmi se paku 3 projekte), në vlerë të përgjithshme prej së paku LOT 1 - 61,500.00 euro , LOT 2 - 52,500.00 euro , LOT 3 - 45,000.00 euro. | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat e realizuara me përvojë në mbikqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe renovuese, ku përfshihen edhe masat EE në 3 vitet e fundit (dëshmi se paku 3 projekte) ku për secilën kontratë të specifikohet data e përfunduar, lloji i shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës. Shuma totale e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë duhet të jetë jo më pak se LOT 1 - 61,500.00 euro , LOT 2 - 52,500.00 euro , LOT 3 - 45,000.00 euro. Dëshmitë që duhet të dorëzohet janë kopje të kontratës, referenca ose vërtetim nga përfituesit). |
| Kompania të ketë së paku pesë (5) punonjës të kualifikuar dhe me përvojë të dëshmuar në fushën e mbikqyrjes së zbatimit të projekteve renovuese dhe ndërtimore ku janë përfshirë masat EE. 1. Udhëheqësi i ekipit duhet të ketë | 2. Një listë e stafit të nënshkruar dhe vulosur nga OE e cila paraqet stafin e përcaktuar apo angazhuar dhe pozitën. 2. Për të dëshmuar kualifikimet dhe përvojën e stafit të angazhuar, për secilin anëtar të ekipit duke përfshirë |

| | |
|--|---|
| <p>diplomë master apo ekuivalente në inxhinieri ose arkitekturë me të paktën 5 vite përvojë relevante në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe mbikqyrje të zbatimit të projekteve renovuese dhe ndërtimore ku janë përfshirë masat EE. Duhet të ketë Licencë A, të lëshuar nga Oda e Inxhinierëve Arkitektëve e Republikës së Kosovës, e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës dhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. 2.</p> <p>Arkitekti duhet të ketë diplomë master apo ekuivalente dhe të paktën 3 vite përvojë përvojë profesionale relevante në mbikqyrje të zbatimit të projekteve renovuese dhe ndërtimore ku janë përfshirë masat EE; Duhet të posedojë Licencë A, të lëshuar nga Oda e Inxhinierëve Arkitektëve e Republikës së Kosovës, e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës dhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. 3. Inxhinieri i makinerisë duhet të ketë diplomë master apo ekuivalente në inxhinieri mekanike makinerike dhe të paktën 3 vite përvojë profesionale relevante në mbikqyrje të zbatimit të projekteve renovuese dhe ndërtimore ku janë përfshirë masat EE; Duhet të ketë Licencë A, të lëshuar nga Oda e Inxhinierëve Arkitektëve e Republikës së Kosovës, e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës dhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. 4. Inxhinieri i elektroteknikës duhet të ketë diplomë master apo ekuivalente në inxhinieri dhe të paktën 3 vite përvojë në mbikqyrje të zbatimit të projekteve renovuese dhe ndërtimore ku janë përfshirë masat EE; Duhet të ketë Licencë A, të lëshuar nga Oda e Inxhinierëve Arkitektëve e Republikës së Kosovës, e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës dhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. 5.</p> <p>Zyrtari për shëndet dhe siguri në punë të ketë diplomë në drejtime inxhinierike minimalisht të nivelit bachelor me tri vite përvojë pune në projekte të natyrës së njejtë, duke përfshirë jo më pak se 2 vite përvojë specifike në shëndet dhe siguri në punë. Të jetë i certifikuar me certifikatë valide sipas ISO 45001. 6.</p> <p>Specialist i Mjedisit duhet të ketë diplomë në drejtime inxhinierike minimalisht të nivelit bachelor me 3 vite përvojë të punës në projekte të ngjashme, duke përfshirë jo më pak se 2 vite përvojë specifike si Specialist i Mjedisit.</p> | <p>menaxherin e projektit, përvojat e kërkuara duhet të dëshmohen me dokumentet përkatëse (CV, kontratë, vërtetim referencë nga punëdhënësi sipas kontratave të ofruara), kurse shkollimi të dëshmohet përmes diplomave dhe certifikatave përkatëse). Të gjitha diplomat dhe certifikatat duhet të jenë të noterizuara.</p> |
| <p>3.Vendim me shkrimi për caktimin e menaxherit të Projektit i nënshkruar dhe vulosur nga OE.</p> | <p>3.Vendim me shkrimi për caktimin e menaxherit të Projektit i nënshkruar dhe vulosur nga OE.</p> |
| <p>4. OE duhet të ketë një marrëveshje të nënshkruar ose kontrata të lidhura të punës me ekipin e angazhuar lidhur me projektin në fjalë.</p> | <p>4. Marrëveshja e nënshkruar ose kopjet e kontratave të lidhura në mes të OE dhe ekipit të angazhuar lidhur me projektin në fjalë.</p> |

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po Jo

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2) Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po Jo

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

E hapur

E kufizuar

Konkurruese me negociata

Kuotim i Çmimit

IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të riekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po Jo

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po Jo

IV.1.4) Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5) Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do të përdoret ankandi elektronik: Po Jo

Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

Grupi 1. Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 1,

Çmimi më i ulët: Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të:

| | Nënkriteret | Koeficient |
|--|-------------|------------|
| | | |

Grupi 2. Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 2,

Çmimi më i ulët: Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të:

| | Nënkriteret | Koeficient |
|--|-------------|------------|
| | | |

Grupi 3. Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale - LOT 3,

Çmimi më i ulët: Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të:

| | Nënkriteret | Koeficient |
|--|-------------|------------|
| | | |

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po Jo

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i
i

Po Jo

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranimit të tenderëve / aplikacioneve:

data 10.06.2026 koha 14:00:00 vendi e-prokurimi

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

Po Jo

Nëse po, jep arsyetim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **1,000.00 Euro**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **90** apo muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **60** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data **10.06.2026** koha **14:00:00** vendi **e-prokurimi**

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

KËRKESË PËR SQARIM TE DOSJES SË TENDERIT
PËR: **FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERGJISË**

NGA: STUDIO LINKS 4, PRISHTINE
Date: 03.06.2026

TITULLI I TENDERIT: Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të ee në ndërtesat komunale

NR. PROKURIMIT: 213 27 400 26 3625 221

I nderuar z. Spahiu,

Gjatë analizimit të Dosjes së Tenderit (DT), kemi hasur në disa paqartësi për të cilat kërkojmë këtë sqarim:

Kerkesa per sqarim 1:

Ju lutemi të konfirmoni se vlera e parashikuar është llogaritur në përputhje me nenin 56.6 të Rregullores 001/2022 dhe se përfshin një vlerësim real të kostove të stafit, shpenzimeve operative, transportit, komisionimit dhe mbikëqyrjes gjatë periudhës DLP.

Kërkesa për sqarim 2:

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kjo kërkesë: Dëshmi me shkrim (Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave).

Meqenëse është lidhësja “dhe” kjo është shkruar në formën që nënkupton se dëshmitë janë kontrata, certifikata e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi apo ndoshta lidhësja duhet të jete “ose”

Ndërsa tek UDHËZUES NR. 002/2024

iv. Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së):

- Në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, AK mund të kërkoj nga OE një listë të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet t'i bashkëngjiten si dëshmi:

1. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.

2. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

Meqenëse Legjislacioni njih vetem certifikata, Raport pranimi (te konsulences) dhe referencen, a pranohen deshmitë e leshuara nga Autoriteti Kontraktues FKEE të quajtura si Vërtetime ose Konfirmime dhe a ekuivalentohen këto me kërkesat ligjore (edhe doracaku njëj Raportin e pranimit si dokument përmbylles të kontratës së konsulences)

Me respekt
Nafije Gashi
Studio LINKS 4





REPUBLIC OF KOSOVA

Kosovo Energy Efficiency Fund (KEEF)

Informacione, sqarime shtesë

Data: 05.06.2026

Titulli: Kompani konsultente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të ee në ndërtesat komunale, NR. PROKURIMIT: 213 27 400 26 3625 221

| NR | Pyetja | Përgjigja |
|----|--|--|
| 1. | <p>Kërkesa per sqarim 1:</p> <p>Per Lot 3 konsiderojme qe Buxheti eshte percaktuar ne kundershtim me Rregullore 001 2022 Neni 56.6</p> <p>Zhvillim i vlerësimeve të kostos dhe buxheti</p> <p>56.6 AK pas zhvillimit të TeR duhet ta vlerësoj koston e detyrës. Gjatë zhvillimit të vlerësimeve të kostos AK duhet ta llogarisë koston e stafit, akomodimit të zyrës, kostot e operimit, transportimin dhe shpërndarjet, si dhe me mundësi të zgjedhjes shpenzimet e kryerjes së testeve ose marrjes së mostrave. Vlerësimi i kostos do të përdoret si bazë për përcaktimin e disponueshmërisë së financimit. Kostot duhet të ndahen në dy kategori të gjëra:</p> <p>a. pagesa (ose paga) stafi kryesore dhe stafi tjetër; dhe</p> <p>b. të kompozuar- Transporti (Ajër/Tokë), Akomodimi i stafit (Zyre/Qira), Orendi/Pajisje, Furnizim/ Komunal, Raporte, /Dokumente /përkthim, editim/printim).</p> <p>Nese buxheti juaj nuk mbulon as pagat minimale (obligative me Ligj) te stafit per nje vit ateher, na sqaroni ne cfar baze ligjore keni pasur ne mendje kur keni ndare buxhetin per 3 vjet qe ta perdorim edhe ne dhe qe te jemi ne perputhje me ligjin e pagave ne Kosove?</p> | <p>1. përputhje me nenin 6 dhe nenin 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, duke u bazuar në hulumtimin e tregut dhe nevojat funksionale të projektit.”</p> <p>“Në përputhje me nenin 7 të LPP-së (parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit), Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë ose rishqyrtojë strukturën e brendshme të kostove të operatorëve ekonomikë, përfshirë pagat, organizimin e stafit apo mënyrën e menaxhimit të resurseve njerëzore.”</p> <p>“Çdo operator ekonomik është i lirë të organizojë strukturën e tij të koston, me kusht që të respektohen obligimet ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë legjislacionin tatimor dhe atë të punës.”. Ne nuk jemi duke punësuar dike qe te përcaktojmë pagën minimale, rrjedhimisht, ky është obligim i OE në raport me punëtorët e vet.</p> |

| | | |
|-----------|--|--|
| | <p>Buxheti 30,000 euro bruto ndersa pas TVSh e cila nuk faturohet ne paga mbetet 25,423 euro 25,423/5inxhinier/12muaj=423.71 euro page. 423.71<500 euro paga minimale. Nese perfshihet DLP dhe shpenzimet operative del paga me e vogel se 200 euro.</p> | |
| <p>2.</p> | <p>Kërkesa per sqarim 2:</p> <p>Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kjo kërkesë: Dëshmi me shkrim (Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikëqyrjes se punimeve sipas kontratave). Megenësë është lidhësja “dhe” kjo është shkruar në formën që nënkupton se dëshmitë janë kontrata, certifikata e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi apo ndoshta lidhësja duhet te jete “ose” Ndersa tek UDHËZUES NR. 002/2024 iv. <i>Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së):</i> - Në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, AK mund të kërkoj nga OE një listë të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet t’i bashkëngjiten si dëshmi: 1. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. 2. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë; Megenëse Legjislacioni njih vetem certifikata, Raport pranimi (te konsulences) dhe referencen, a pranohen dëshmitë e leshuara nga Autoriteti Kontraktues FKEE të quajtura si Vërtetime ose Konfirmime dhe a ekuivalentohen keto me kërkesat ligjore (edhe doracakun e Raportin e pranimit si dokument permbylles te kontrates se konsulences)</p> | <p>2. “Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesat janë mese te qarta dhe dokumentet e prezantuar duhet te jenë saktë sipas kërkesave te paraqitura ne FDT. Sa i përket pikës OSE dhe DHE, ne FDT është qartazi e shprehur fjala DHE, kjo nënkupton si kërkesë mandatorë edhe për ato qe janë pas fjalës DHE! Si përfundim realizimi i kërkesës është si vijon: 1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat e realizuara me përvojë në mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe renovuese, ku përfshihen edhe masat EE në 3 vitet e fundit (dëshmi se paku 3 projekte/ndërtesa) ku për secilën kontratë të specifikohet data e përfunduar, lloji i shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës. Shuma totale e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit nga data e publikimit te Njoftimit për Kontratë duhet të jetë jo më pak se LOT 1 - 61,500.00 euro , LOT 2 - 52,500.00 euro , LOT 3 - 45,000.00 euro. Dëshmi me shkrim (Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokolluara nga përfituesi për kryerje të mbikëqyrjes se punimeve sipas kontratave). Sa i përket paragrafit te fundit te pyetjes se dyte, ju sqarojmë se është kërkuar REFERENCA dhe nuk ka një dokument tjetër qe e zëvendëson si te tille, d.m.th. REFERENCA nuk i nënkupton edhe dokumentet e cekura nga ana juaj, të quajtura si Vërtetime ose Konfirmime!</p> |

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|------------------------|--------------------------------|
| Nr i Prokurimit | 213/27400-26-3625-2-2-1 |
| Nr i brendshëm | |

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

| | |
|--|--------------------------------|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | NNP.STUDIO LINKS 4 |
| NUI | 810533887 |
| Adresa | Rruga Sokol Sopi, |
| Vendi | Prishtine |
| Kodi postar | 10000 |
| Numri Telefonit | +383/45555985 |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | Nafije Gashi Ademi |
| Adresa elektronike | links.projekt@yahoo.com |
| Data e parashtrimit të kërkesës | 06.06.2026 |

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Njoftim per kontrate - Titulli: Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale Nr. AP: 213/27400-26-3625-2-2-1

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Neni 7 i LPP-së

2. Neni 69 i LPP-së

3. Udhëzuesi Operativ Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, Kapitulli IV – Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së), faqe 29-30.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Pika 1. Kritere jo ne perputhje me Neni 69

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale -deshmia e kerkuar:

1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat e realizuara me përvojë në mbikqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe renovuese, ku përfshihen edhe masat EE në 3 vitet e fundit (dëshmi se paku 3 projekte/ndertesa) ku për secilën kontratë të specifikohet data e përfunduar, lloji i shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës. Shuma totale e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë duhet të jetë jo më pak se LOT 1 - 61,500.00 euro , LOT 2 - 52,500.00 euro , LOT 3 - 45,000.00 euro.

Dëshmi me shkrim (Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave)..

Ne lidhje me “Dëshmi me shkrim” ne si OE kemi bere pyetje sqaruese se a mund te perdoret si deshmi edhe dokumenti i quajtur “Konfirmim/vertetim” i leshuar nga vet AK?

Interpretimi i kriterit nga AK (bashkangjitur) eshte : *ju sqarojmë se është kërkuar REFERENCA dhe nuk ka një dokument tjetër që e zëvendëson si te tille, d.m.th. REFERENCA nuk i nënkupton edhe dokumentet e cekura nga ana juaj, të quajtura si Vërtetime ose Konfirmime!*

Vlerësojmë se ky interpretim nuk është në përputhje me nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me Udhëzuesin Operativ të KRPP-së.

Neni 69 përcakton se për kontratat e realizuara për autoritete publike, dëshmi e realizimit të kontratës shërben dokumenti i lëshuar nga autoriteti publik. Ndërsa Udhëzuesi Operativ i KRPP-së interpreton Neni 69 të LPP keshtu: *Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.*

Nga kjo rezulton se legjislacioni nuk e kushtëzon pranueshmërinë e dokumentit me emërtimin e tij, por me përmbajtjen dhe faktin që ai dëshmon realizimin e kontratës.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues, gjatë përmbjlljes së kontratave të shërbimeve, ka lëshuar dokumente zyrtare të titulluara “Konfirmim” dhe “Vërtetim”, përmes të cilave konfirmohet realizimi i kontratës, përmbushja e detyrimeve kontraktuale, periudha e realizimit dhe vlera e kontratës. Këto dokumente përmbajnë të gjitha informacionet që zakonisht përmban një referencë dhe shërbejnë për të njëjtin qëllim dhe tani vet AK refuzon t’i pranoj keto te njejtat.

Në praktikë, shumë kontrata të shërbimeve përmbjllen me konfirmime, vërtetime apo dokumente të ngjashme zyrtare dhe jo domosdoshmërisht me dokumente të titulluara “Referencë”. Për këtë arsye, refuzimi i tyre vetëm për shkak të emërtimit formal nuk ndikon në vërtetimin e përvojës profesionale, por kufizon pa nevojë mundësinë e operatorëve ekonomikë për të dëshmuar përvojën e tyre.

Qëllimi i nenit 69 është të dëshmohet se kontrata është realizuar me sukses dhe jo të kërkohej një titull i caktuar i dokumentit që e dëshmon atë.

Veçanërisht shqetësues është fakti se vetë Autoriteti Kontraktues-FKEE, gjatë zbatimit dhe përmbjlljes së kontratave të mëparshme, ka lëshuar dokumente të titulluara “Konfirmim” dhe “Vërtetim” si dëshmi të realizimit të kontratave, pa njoftuar paraprakisht operatorët ekonomikë se këto dokumente nuk do të konsideroheshin të vlefshme për dëshmimin e përvojës profesionale në aktivitetet e ardhshme të prokurimit. Operatorët ekonomikë kanë vepruar në mirëbesim dhe kanë pranuar dokumentacionin zyrtar të lëshuar nga vetë Autoriteti Kontraktues, duke pasur pritje të arsyeshme se dokumente të tilla janë të rregullta, të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore për dëshmimin e realizimit të kontratave. Për pasojë, operatorët ekonomikë tani përballen me

rrezikun e përjashtimit nga procedura për shkak të një kriteri formal që nuk ka qenë i njohur, i komunikuar apo i parashikueshëm në kohën e realizimit të kontratave..

Për më tepër, interpretimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues bie ndesh edhe me parimet e përcaktuara në nenin 7 të LPP-së. Dokumentet e titulluara “Konfirmim” apo “Vërtetim”, të lëshuara nga autoritetet publike dhe që dëshmojnë realizimin e kontratës, po refuzohen vetëm për shkak të emërimit të tyre formal, ndonëse përmbajtja e tyre është e njëjtë me atë të një reference. Për pasojë, operatorët ekonomikë që posedojnë dokumente të tilla vendosen në pozitë të pabarabartë dhe kufizohen pa nevojë në dëshmimin e përvojës së tyre profesionale.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë sqarimin e publikuar dhe të konfirmojë se për qëllime të dëshmimit të përvojës teknike dhe profesionale do të pranohen edhe dokumente ekuivalente të lëshuara nga vet FKEE, si konfirmime, vërtetime, raporte pranimi apo dokumente të tjera zyrtare që dëshmojnë realizimin e kontratës dhe përmbajnë informacionet përkatëse mbi përmbushjen dhe vlerën e saj.

Pika 2. Kritere joproporcionale dhe që zvoglojnë konkurrencen

Në Dosjen e Tenderit, perseri tek seksioni “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, kërkohet: *Kontratata, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave)*

Lidhur me sqarimin e publikuar nga Autoriteti Kontraktues, ku është deklaruar se lidhëza “DHE” nënkupton paraqitjen e detyrueshme të kontratës, certifikatës së pranimit teknik dhe referencës për secilën kontratë, konsiderojmë se një kërkesë e tillë është e panevojshme dhe tepër kufizuese. Kjo për arsye se të gjitha këto dokumente shërbejnë për të dëshmuar të njëjtin fakt, përkatësisht se kontrata është realizuar me sukses. Nëse realizimi i kontratës tashmë dëshmohet përmes kontratës dhe një dokumenti zyrtar të lëshuar nga autoriteti publik, si referencë, konfirmim, vërtetim apo certifikatë pranimi, atëherë kërkimi i dokumenteve shtesë që dëshmojnë të njëjtën gjë nuk sjell ndonjë vlerë shtesë në vlerësimin e përvojës profesionale. Përkundrazi, krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe kufizon konkurrencën, veçanërisht kur vetë Autoriteti Kontraktues ka pasur praktikë të lëshojë “Konfirmime” dhe “Vërtetime” në vend të referencave.

Pika 3. Zbatim jo i njëtrajtshëm i kriterëve për dëshmimin e përvojës

Në Dosjen e Tenderit, perseri tek seksioni “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”,

2.Për të dëshmuar kualifikimet dhe përvojën e stafit të angazhuar, për secilin anëtar të ekipit duke përfshirë menaxherin e projektit, përvojat e kërkuara duhet të dëshmohen me dokumentet

përkatëse (CV, kontratë, vërtetim referencë nga punëdhënësi sipas kontratave të ofruara), kurse shkollimi të dëshmohet përmes diplomave dhe certifikatave përkatëse).

Lidhur me kërkesën për dëshmimin e përvojës së stafit, vërehet një mospërputhje në vetë kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Për dëshmimin e përvojës së stafit kërkohet që përvoja të dëshmohet përmes “**vërtetimit/referencës nga punëdhënësi**”, çka nënkupton se Autoriteti Kontraktues i konsideron të pranueshme të dyja format e dokumentimit. Ndërsa për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik, në sqarimet e publikuara është deklaruar se “Konfirmimet” dhe “Vërtetimet” nuk konsiderohen dokumente ekuivalente me referencën.

Nuk është e qartë pse për të njëjtin qëllim tek i njëjti seksion i FDT, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, pra për dëshmimin e përvojës së mëparshme, Autoriteti Kontraktues aplikon standarde të ndryshme për piken 1 të kërkesës dhe për piken 2 të kërkesës. Në të njëjtin seksion standard i ndryshem.

Për pasojë, pranimi i vërtetimeve për dëshmimin e përvojës së stafit, ndërsa refuzimi i tyre për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik, krijojnë një trajtim jo të njëjtë për kërkesat për dëshmimin e përvojës dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

Gjithashtu përvojat e fituara para 10 apo 15 viteve shpesh nuk mund të dëshmohen përmes kontratave, pasi dokumente të tilla mund të mos ruhen më. Për këtë arsye, referencat dhe vërtetimet e lëshuara nga punëdhënësit përbëjnë një formë të arsyeshme dhe të zakonshme të dëshmimit të përvojës profesionale.

Për më tepër, në një procedurë të mëhershme të zhvilluar nga i njëjti Autoritet Kontraktues, lidhur me mungesën e kontratave të punës për stafin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, Autoriteti Kontraktues është pergjigjur se referencat e paraqitura ishin të mjaftueshme për të dëshmuar natyrën e shërbimeve, kohëzgjatjen e angazhimit dhe përvojën specifike të kërkuar. Ky proces është i dokumentuar në arkivat e OSHP-se.

Nga kjo rezulton se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar më herët se dokumentet që dëshmojnë përvojën dhe realizimin e angazhimeve kanë përparësi ndaj formës së dokumentit. Për këtë arsye, nuk është e qartë pse në procedurën aktuale po aplikohet një standard më i rreptë, ku dokumentet zyrtare të titulluara “Konfirmim” apo “Vërtetim”, edhe pse dëshmojnë realizimin e kontratës, nuk konsiderohen të pranueshme për shkak të emërimit të tyre formal.

Rekomandojmë që të perdoret i njëjti standard edhe të pika 1 “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” por edhe të mos kërkohen kontratat për dëshmi të përvojës së stafit.

Pika 4. Buxheti i pamjaftueshëm për të realizuar kërkesat sipas TeR

Duke marrë parasysh numrin e ekspertëve të kërkuar, kualifikimet minimale, përvojën e kërkuar, si dhe detyrat dhe angazhimet e përcaktuara në Termat e Referencës, vlera e kontratës duket e pamjaftueshme në raport me kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues. Kjo bëhet edhe më

e rëndësishme duke pasur parasysh nivelin e pagës minimale në fuqi dhe rritjen e saj në 500 € nga 1 korriku 2026.

Për më tepër, sipas nenit 56.6 të Rregullores Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues obligohet që gjatë zhvillimit të vlerësimit të kostos dhe përcaktimit të buxhetit të sigurojë që vlera e parashikuar e kontratës të jetë reale dhe e mjaftueshme për realizimin e kërkesave të kontratës.

Bazuar në kërkesat në Terma te rferencës, duhet të bëhen inspektime dy herë në javë për secilën ndërtesë . Lot 3 përfshinë lokacionin në Karacevë dhe Klinë e Decan e që kjo nënkupton se nuk mund të vizitohen brenda një dite të gjitha lokacionet. Prandaj dy vizita në javë për secilin objekt sipas TeR nënkupton 4 ditë në javë punë në terren. Shto kësaj raportimin në FKEE i bjen që angazhimi të jetë i rregulltë me 5 ditë në javë. Tabela me poshte e sqaron kete:

| | viti 1 | | | viti 2 | | |
|------------------------|-------------|---------------|---------|-----------|--------|---------|
| stafi | angazhimi | pagesa | 12 muaj | angazhimi | pagesa | 12 muaj |
| Menaxheri | plote | 1000 | 12000 | gjysem | 500 | 6000 |
| staf 1 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| staf 2 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| staf3 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| staf 4 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| | | | 36000 | | | 6000 |
| Shpenzime operacionale | | | | | | |
| transport | 4 here jave | 100 euro/jave | 4800 | | | |
| tjera | | 100 euro/muaj | 1200 | | | |
| | | | 6000 | | | |
| total pa tvsh | | 48000 | | | | |
| tvsh 18% | | 8640 | | | | |
| total me tvsh | | 56640 | | | | |

Në rastin konkret, ekziston dyshimi i arsyeshëm se buxheti i paraparë nuk është në përpjesëtim me nivelin e ekspertizës dhe angazhimeve të kërkuara në Termat e Referencës, prandaj kërkojmë që kjo çështje të rishqyrtohet.

Kerkojme qe te rritet buxheti konform kerkesave te TeR.

1. Dëmet materiale

Ne si OE rrezikojme të përjashtohemi nga procedura e prokurimit jo për shkak të mungesës së përvojës profesionale, por për shkak të një interpretimi formal nga vet AK të dokumentacionit të kërkuar. Si pasojë, na pamundësohet pjesëmarrja dhe konkurrimi i barabartë në këtë aktivitet të prokurimit, duke shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë material dhe duke kufizuar konkurrencën efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

2. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit
t
ë pasukseshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*



FKEE
FONDI I KOSOVËS PËR EFICIENCË TË ENERJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

REPUBLIC OF KOSOVA

Kosovo Energy Efficiency Fund (KEEF)

Zyra e prokurimit te FKEE, në bazë të kërkesës për rishqyrtim të bërë me datë **09.06.2026** nga Operatori Ekonomik “**NNP.STUDIO LINKS 4**”, në lidhje me aktivitetin e prokurimi: **Kompani konsulente për mbikqyrjen e zbatimit të projekteve, kontrollin e cilësisë, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen në adresimin e defektve gjatë periudhës së garancise së punimeve, për zbatimin e masave të EE në ndërtesat komunale, NR. PROKURIMIT: 213/27400-26-3625-2-2-1**, duke u bazuar në rregullat që adoptojnë, plotësojnë dhe japin sqarime për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, i cili në pajtim me nenin 108/A të ligjit mbi prokurimin publik nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092 sjellë këtë:

VENDIM

REFUZOHET si PA BAZUAR kërkesa e Operatorit Ekonomik “**NNP.STUDIO LINKS 4**”

ARSYETIM

Lidhur me kërkesën tuaj për rishqyrtim, nga ana e Autoritetit Kontraktues e njëjta vlerësohet si e pa bazuar e që bazën për këtë konkludim të AK e gjeni në elaborimin e secilit argument tuajin të përmendur në Kërkesën për Rishqyrtim.

Në arsyetimin e mëposhtëm do të trajtohet kërkesa juaj për rishqyrtim ku keni përmendur nenet ku supozoni se është bërë shkelje e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullave të Prokurimit Publik.

Nga ana e juaj janë listuar nenet: Neni 7 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së dhe Udhëzuesi Operativ Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, Kapitulli IV – Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së), faqe 29-30.

Është shumë e rëndësishme të theksohet fakti, se Autoriteti Kontraktues, lidhur me këtë procedurë të prokurimit me qëllim të respektimit dhe aplikimit të parimeve të prokurimit ka vendosur që të përdoret metoda më transparente e procedurave të prokurimit, “**Procedura e Hapur**” dhe është përzgjedhur kriteri i dhënies “**Tenderi i ekonomikisht më i favorshëm**” me të vetmin qëllim kualitetin e shërbimeve dhe janë përcaktuar kushte dhe kërkesa të cilat në asnjë mënyrë nuk do ta diskriminojnë apo favorizojnë ndonjë OE, përderisa të njëjtit përmbushin kriteret e përzgjedhjes, kushtet dhe kërkesat e DT.

Për të trajtuar konkretisht bazën e pretendimeve tuaja në këtë kërkesë, dhe refuzimin e kërkesës nga ana e AK.

Tutje, do ti sqarojmë konstatimet e mëposhtme:

- Pretendimi 1

Pika 1. Kriteria jo ne perputhje me Neni 69

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale -deshmia e kerkuar:

1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat e realizuara me përvojë në mbikqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe renovuese, ku përfshihen edhe masat EE në 3 vitet e fundit (dëshmi se paku 3 projekte/ndertesa) ku për secilën kontratë të specifikohet data e përfunduar, lloji i shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës. Shuma totale e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë duhet të jetë jo më pak se LOT 1 - 61,500.00 euro , LOT 2 - 52,500.00 euro , LOT 3 - 45,000.00 euro.

Dëshmi me shkrim (Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave)..

Ne lidhje me “Dëshmi me shkrim” ne si OE kemi bere pyetje sqaruese se a mund te perdoret si deshmi edhe dokumenti i quajtur “Konfirmim/vertetim” i leshuar nga vet AK?

Interpretimi i kriterit nga AK (bashkangjitur) eshte : ju sqarojmë se është kërkuar REFERENCA dhe nuk ka një dokument tjetër që e zëvendëson si të tillë, d.m.th. REFERENCA nuk i nënkupton edhe dokumentet e cekura nga ana juaj, të quajtura si Vërtetime ose Konfirmime!

Vlerësojmë se ky interpretim nuk është në përputhje me nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me Udhëzuesin Operativ të KRPP-së.

Neni 69 përcakton se për kontratat e realizuara për autoritete publike, dëshmi e realizimit të kontratës shërben dokumenti i lëshuar nga autoriteti publik. Ndërsa Udhëzuesi Operativ i KRPP-së interpreton Neni 69 të LPP kështu: Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.

Nga kjo rezulton se legjislacioni nuk e kushtëzon pranueshmërinë e dokumentit me emërtimin e tij, por me përmbajtjen dhe faktin që ai dëshmon realizimin e kontratës.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues, gjatë përmbjlljes së kontratave të shërbimeve, ka lëshuar dokumente zyrtare të titulluara “Konfirmim” dhe “Vërtetim”, përmes të cilave konfirmohet realizimi i kontratës, përmbushja e detyrimeve kontraktuale, periudha e realizimit dhe vlera e kontratës. Këto dokumente përmbajnë të gjitha informacionet që zakonisht përmban një referencë dhe shërbejnë për të njëjtin qëllim dhe tani vet AK refuzon t’i pranoj keto te njejtat.

Në praktikë, shumë kontrata të shërbimeve përmbjllen me konfirmime, vërtetime apo dokumente të ngjashme zyrtare dhe jo domosdoshmërisht me dokumente të titulluara “Referencë”. Për këtë arsye, refuzimi i tyre vetëm për shkak të emërimit formal nuk ndikon në vërtetimin e përvojës profesionale, por kufizon pa nevojë mundësinë e operatorëve ekonomikë për të dëshmuar përvojën e tyre.

Qëllimi i nenit 69 është të dëshmohet se kontrata është realizuar me sukses dhe jo të kërkohet një titull i caktuar i dokumentit që e dëshmon atë.

Veçanërisht shqetësues është fakti se vetë Autoriteti Kontraktues-FKEE, gjatë zbatimit dhe përmbjlljes së kontratave të mëparshme, ka lëshuar dokumente të titulluara “Konfirmim” dhe “Vërtetim” si dëshmi të realizimit të kontratave, pa njoftuar paraprakisht operatorët ekonomikë se këto dokumente nuk do të konsideroheshin të vlefshme për dëshmimin e përvojës profesionale në aktivitetet e ardhshme të prokurimit. Operatorët ekonomikë kanë vepruar në mirëbesim dhe kanë pranuar dokumentacionin zyrtar të lëshuar nga vetë Autoriteti Kontraktues, duke pasur pritje të arsyeshme se dokumente të tilla janë të rregullta, të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore për dëshmimin e realizimit të kontratave. Për pasojë, operatorët ekonomikë tani përballen me rrezikun e përjashtimit nga procedura për shkak të një kriteri formal që nuk ka qenë i njohur, i komunikuar apo i parashikueshëm në kohën e realizimit të kontratave..

Për më tepër, interpretimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues bie ndesh edhe me parimet e përcaktuara në nenin 7 të LPP-së. Dokumentet e titulluara “Konfirmim” apo “Vërtetim”, të lëshuara nga autoritetet publike dhe që

dëshmojnë realizimin e kontratës, po refuzohen vetëm për shkak të emërimit të tyre formal, ndonëse përmbajtja e tyre është e njëjtë me atë të një reference. Për pasojë, operatorët ekonomikë që posedojnë dokumente të tilla vendosen në pozitë të pabarabartë dhe kufizohen pa nevojë në dëshmimin e përvojës së tyre profesionale. Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë sqarimin e publikuar dhe të konfirmojë se për qëllime të dëshmimit të përvojës teknike dhe profesionale do të pranohen edhe dokumente ekuivalente të lëshuara nga vet FKEE, si konfirmime, vërtetime, raporte pranimi apo dokumente të tjera zyrtare që dëshmojnë realizimin e kontratës dhe përmbajnë informacionet përkatëse mbi përmbushjen dhe vlerën e saj.

Përgjigje në pretendimin nr1

Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si plotësisht të pabazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në aspektin juridik.

Fillimisht, AK sqaron se neni 69 i LPP-së përcakton mundësinë ligjore të Autoritetit Kontraktues për të kërkuar dëshmi lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, duke i dhënë njëkohësisht të drejtën diskrecionale AK-së që, varësisht nga natyra, kompleksiteti dhe rëndësia e kontratës, të përcaktojë mënyrën konkrete të dëshmimit të përvojës profesionale.

Në rastin konkret, kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë e qartë, e saktë dhe e publikuar paraprakisht për të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, ku është kërkuar:

“Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokolluara nga përfituesi”.

Rrjedhimisht, AK ka përcaktuar qartë llojin e dokumentacionit që duhet të dorëzohet për të dëshmuar realizimin e kontratave të ngjashme.

Pretendimi i OE-së se dokumentet e titulluara “Konfirmim” apo “Vërtetim” duhet automatikisht të konsiderohen ekuivalente me referencat, nuk qëndron, për faktin se legjislacioni i prokurimit publik nuk e kufizon Autoritetin Kontraktues që të kërkojë dokumente specifike dhe forma të caktuara të dëshmimit, për aq kohë sa ato kërkesa janë objektive, proporcionale dhe të aplikuar në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

AK vlerëson se referenca, si dokument i kërkuar në FDT, ka natyrë dhe përmbajtje specifike, pasi përmes saj jo vetëm konfirmohet ekzistenca e kontratës, por gjithashtu vlerësohet cilësia e performancës, realizimi profesional i shërbimeve dhe përmbushja e obligimeve kontraktuale nga operatori ekonomik. Ndërsa dokumentet e titulluara si “Konfirmim” apo “Vërtetim” mund të përmbajnë vetëm elemente deklarative ose administrative mbi ekzistimin apo përfundimin formal të kontratës, pa përmbajtur domosdoshmërisht elementet e vlerësimit profesional që kërkohen nga AK.

Për më tepër, pretendimi se AK po vepron në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së nuk qëndron, pasi ky nen nuk e ndalon Autoritetin Kontraktues të specifikojë dokumentacionin që kërkohet për dëshmimin e përvojës profesionale. Përkundrazi, neni 69 i LPP-së i jep të drejtë AK-së të kërkojë dëshmi adekuate dhe relevante për të verifikuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, interpretimi i OE-së lidhur me Udhëzuesin Operativ Nr. 002/2024 nuk mund të prevalojë mbi dispozitat e FDT-së, pasi udhëzuesi operativ ka karakter interpretues dhe orientues, ndërsa kriteret konkrete të procedurës janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit, e cila ka qenë publike dhe e qasshme për të gjithë operatorët ekonomikë para afatit të ofertimit.

Sa i përket pretendimit se AK më herët ka lëshuar dokumente të titulluara “Konfirmim” apo “Vërtetim”, kjo nuk krijon obligim juridik që të njëjtat dokumente të konsiderohen automatikisht të mjaftueshme për çdo procedurë

të ardhshme të prokurimit. Çdo aktivitet i prokurimit është autonom dhe zhvillohet mbi bazën e kërkesave specifike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit përkatës.

Po ashtu, pretendimi për cenim të nenit 7 të LPP-së është i pabazuar, për faktin se kriteret dhe kërkesat janë aplikuar në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, pa favorizim apo kufizim selektiv ndaj ndonjë operatori të caktuar.

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimi i OE-së nuk ka bazë ligjore dhe kërkesa për rishqyrtim në këtë pjesë refuzohet si e pabazuar.

- Pretendimi 2

Pika 2. Kritere joproporcionale dhe që zvoglojnë konkurrencen

Në Dosjen e Tenderit, perseri tek seksioni “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, kërkohet: Kontratat, certifikatat e pranimit teknik dhe referencat e vulosura apo protokoluara nga përfituesi për kryerje të mbikqyrjes së punimeve sipas kontratave)

Lidhur me sqarimin e publikuar nga Autoriteti Kontraktues, ku është deklaruar se lidhëza “DHE” nënkupton paraqitjen e detyrueshme të kontratës, certifikatës së pranimit teknik dhe referencës për secilën kontratë, konsiderojmë se një kërkesë e tillë është e panevojshme dhe tepër kufizuese. Kjo për arsye se të gjitha këto dokumente shërbejnë për të dëshmuar të njëjtin fakt, përkatësisht se kontrata është realizuar me sukses. Nëse realizimi i kontratës tashmë dëshmohet përmes kontratës dhe një dokumenti zyrtar të lëshuar nga autoriteti publik, si referencë, konfirmim, vërtetim apo certifikatë pranimi, atëherë kërkimi i dokumenteve shtesë që dëshmojnë të njëjtin gjë nuk sjell ndonjë vlerë shtesë në vlerësimin e përvojës profesionale. Përkundrazi, krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe kufizon konkurrencën, veçanërisht kur vetë Autoriteti Kontraktues ka pasur praktikë të lëshojë “Konfirmime” dhe “Vërtetime” në vend të referencave.

- Përgjigje në pretendimin nr2

Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si të pabazuar.

AK sqaron se kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit është formuluar qartë dhe pa paqartësi, ku përmes përdorimit të lidhëzës “DHE” është kërkuar dorëzimi kumulativ i dokumenteve të përcaktuara, respektivisht:

kontrata,
certifikata e pranimit teknik,
dhe referenca e vulosur apo e protokolluar nga përfituesi.

Përdorimi i lidhëzës “DHE” nuk është rezultat i gabimit teknik apo administrativ, por paraqet vullnet të qartë të Autoritetit Kontraktues për të siguruar verifikim të plotë, objektiv dhe të besueshëm të përvojës së operatorëve ekonomikë.

AK vlerëson se secili nga dokumentet e kërkuara ka funksion dhe rol të ndryshëm juridik dhe administrativ:

kontrata dëshmon ekzistimin e marrëdhënies kontraktuale;
certifikata e pranimit teknik dëshmon pranimin formal të shërbimeve;
ndërsa referenca dëshmon performancën dhe realizimin profesional të kontratës.

Prandaj, pretendimi i OE-së se të gjitha dokumentet dëshmojnë “të njëjtin fakt” nuk qëndron, pasi secili dokument mbulon elemente të ndryshme të verifikimit profesional dhe teknik.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ligjore dhe diskrecionale, në përputhje me nenin 69 të LPP-së, të kërkojë nivel të tillë dokumentimi që e konsideron të nevojshëm dhe proporcional për natyrën e kontratës objekt prokurimi, veçanërisht duke marrë parasysh kompleksitetin e shërbimeve të mbikëqyrjes, kontrollit të cilësisë dhe komisionimit të projekteve të eficientës së energjisë.

Gjithashtu, AK konsideron se kërkesa nuk është kufizuese dhe nuk cenon konkurrencën, pasi të gjithë operatorët ekonomikë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe kanë pasur mundësi të barabartë për përgatitjen e ofertave sipas kërkesave të publikuara.

Fakti që një operator ekonomik mund të mos posedojë dokumentacionin e kërkuar nuk e bën kriterin diskriminues apo joproporcional, për atë kohë sa kriteri është objektiv, i arsyeshëm dhe i aplikueshëm për të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të njëjtë.

Për më tepër, AK vlerëson se kërkesat e vendosura janë në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe sigurimit të cilësisë së shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kësaj kontrate.

Rrjedhimisht, pretendimi i OE-së refuzohet si i pabazuar.

Pretendimi 3

Pika 3. Zbatim jo i njëtrajtshëm i kriterëve për dëshmimin e përvojës

Në Dosjen e Tenderit, perseri tek seksioni “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”,

2.Për të dëshmuar kualifikimet dhe përvojën e stafit të angazhuar, për secilin anëtar të ekipit duke përfshirë menaxherin e projektit, përvojat e kërkuara duhet të dëshmohen me dokumentet përkatëse (CV, kontratë, vërtetim referencë nga punëdhënësi sipas kontratave të ofruara), kurse shkollimi të dëshmohet përmes diplomave dhe certifikatave përkatëse).

Lidhur me kërkesën për dëshmimin e përvojës së stafit, vërehet një mospërputhje në vetë kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Për dëshmimin e përvojës së stafit kërkohet që përvoja të dëshmohet përmes “vërtetimit/referencës nga punëdhënësi”, çka nënkupton se Autoriteti Kontraktues i konsideron të pranueshme të dyja format e dokumentimit. Ndërsa për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik, në sqarimet e publikuara është deklaruar se “Konfirmimet” dhe “Vërtetimet” nuk konsiderohen dokumente ekuivalente me referencën.

Nuk është e qartë pse për të njëjtin qëllim tek i njëjti seksion i FDT, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, pra për dëshmimin e përvojës së mëparshme, Autoriteti Kontraktues aplikon standarde të ndryshme për piken 1 të kërkesës dhe për piken 2 të kërkesës. Në të njëjtin seksion standard i ndryshëm.

Për pasojë, pranimi i vërtetimeve për dëshmimin e përvojës së stafit, ndërsa refuzimi i tyre për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik, krijon një trajtim jo të njëtrajtshëm të kërkesave për dëshmimin e përvojës dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

Gjithashtu përvojat e fituara para 10 apo 15 viteve shpesh nuk mund të dëshmohen përmes kontratave, pasi dokumente të tilla mund të mos ruhen më. Për këtë arsye, referencat dhe vërtetimet e lëshuara nga punëdhënësit përbëjnë një formë të arsyeshme dhe të zakonshme të dëshmimit të përvojës profesionale.

Për më tepër, në një procedurë të mëhershme të zhvilluar nga i njëjti Autoritet Kontraktues, lidhur me mungesën e kontratave të punës për stafin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, Autoriteti Kontraktues është përgjigjur se referencat e paraqitura ishin të mjaftueshme për të dëshmuar natyrën e shërbimeve, kohëzgjatjen e angazhimit dhe përvojën specifike të kërkuar. Ky proces është i dokumentuar në arkivat e OSHP-se.

Nga kjo rezulton se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar më herët se dokumentet që dëshmojnë përvojën dhe realizimin e angazhimeve kanë përparësi ndaj formës së dokumentit. Për këtë arsye, nuk është e qartë pse në procedurën aktuale po aplikohet një standard më i rreptë, ku dokumentet zyrtare të titulluara “Konfirmim” apo “Vërtetim”, edhe pse dëshmojnë realizimin e kontratës, nuk konsiderohen të pranueshme për shkak të emërimit të tyre formal.

Rekomandojmë që të perdoret i njëjti standard edhe të pika 1 “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” por edhe të mos kerkohen kontratat për deshmimi të përvojës së stafit.

- Përgjigje në pretendimin nr3

Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si të pabazuar dhe të mbështetur në interpretim të gabuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit.

OE gabimisht tenton të barazojë kriteret për dëshmimin e përvojës së operatorit ekonomik me kriteret për dëshmimin e përvojës së stafit profesional, ndonëse bëhet fjalë për dy kategori të ndryshme juridike dhe funksionale të kualifikimit.

AK sqaron se:

përvoja e operatorit ekonomik lidhet me kapacitetin institucional dhe organizativ të operatorit për realizimin e kontratës;

ndërsa përvoja e stafit lidhet me kapacitetin individual profesional të personave të angazhuar.

Për këtë arsye, është plotësisht legjitime dhe juridikisht e lejuar që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë mënyra të ndryshme të dëshmimit për kategori të ndryshme të kriterëve të kualifikimit.

Në rastin e stafit profesional, referencat apo vërtetimet nga punëdhënësi përdoren për të dëshmuar përvojën individuale profesionale të personave fizikë, ndërsa në rastin e operatorit ekonomik kërkohet dëshmim më i zgjeruar dhe më formal i realizimit institucional të kontratave.

Prandaj, nuk ekziston asnjë trajtim i pabarabartë apo standard i dyfishtë, siç pretendon OE.

Gjithashtu, pretendimet lidhur me praktika të mëhershme apo procedura të tjera të prokurimit nuk kanë relevancë juridike detyruese për procedurën aktuale, pasi çdo aktivitet i prokurimit zhvillohet në mënyrë të pavarur, mbi bazën e kërkesave konkrete të Dosjes së Tenderit dhe nevojave specifike të Autoritetit Kontraktues.

AK gjithashtu vlerëson se kërkesat për dokumentim të përvojës janë proporcionale, objektive dhe të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e kontratës.

Sa i përket pretendimit lidhur me mungesën eventuale të kontratave të vjetra, kjo çështje paraqet përgjegjësi të vetë operatorëve ekonomikë lidhur me ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të tyre profesional dhe nuk mund të shërbejë si bazë për ndryshim të kriterëve të përcaktuara nga AK.

Rrjedhimisht, pretendimi i OE-së refuzohet si i pabazuar.

Pretendimi 4

Pika 4. Buxhet i pamjaftueshem për të realizuar kërkesat sipas TeR

Duke marrë parasysh numrin e ekspertëve të kërkuar, kualifikimet minimale, përvojën e kërkuar, si dhe detyrat dhe angazhimet e përcaktuara në Termat e Referencës, vlera e kontratës duket e pamjaftueshme në raport me kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh nivelin e pagës minimale në fuqi dhe rritjen e saj në 500 € nga 1 korriku 2026.

Për më tepër, sipas nenit 56.6 të Rregullores Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues obligohet që gjatë zhvillimit të vlerësimit të kostos dhe përcaktimit të buxhetit të sigurojë që vlera e parashikuar e kontratës të jetë reale dhe e mjaftueshme për realizimin e kërkesave të kontratës.

Bazuar në kërkesat në Terma te rferencës, duhet të bëhen inspektive dy herë në javë për secilën ndërtesë . Lot 3 përfshinë lokacionin në Karacevë dhe Klinë e Decan e që kjo nënkupton se nuk mund të vizitohen brenda një dite të gjitha lokacionet. Prandaj dy vizita në javë për secilin objekt sipas TeR nënkupton 4 ditë në javë punë në terren. Shtu kësaj raportimin në FKEE i bjen që angazhimi të jetë i rregulltë me 5 ditë në javë. Tabela me poshte e sqaron kete:

| | viti 1 | | | viti 2 | | |
|------------------------|-------------|---------------|---------|-----------|--------|---------|
| stafi | angazhimi | pagesa | 12 muaj | angazhimi | pagesa | 12 muaj |
| Menaxheri | plote | 1000 | 12000 | gjysem | 500 | 6000 |
| staf 1 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| staf 2 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| staf3 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| staf 4 | gjysem | 500/minimale | 6000 | 0 | | 0 |
| | | | 36000 | | | 6000 |
| Shpenzime operacionale | | | | | | |
| transport | 4 here jave | 100 euro/jave | 4800 | | | |
| tjera | | 100 euro/muaj | 1200 | | | |
| | | | 6000 | | | |
| total pa tvsh | 48000 | | | | | |
| tvsh 18% | 8640 | | | | | |
| total me tvsh | 56640 | | | | | |

Në rastin konkret, ekziston dyshimi i arsyeshëm se buxheti i paraparë nuk është në përpjesëtim me nivelin e ekspertizës dhe angazhimeve të kërkuara në Termat e Referencës, prandaj kërkojmë që kjo çështje të rishqyrtohet.

Kerkojme qe te rritet buxheti konform kerkesave te TeR.

1. Dëmet materiale

Ne si OE rrezikojme të përjashtohemi nga procedura e prokurimit jo për shkak të mungesës së përvojës profesionale, por për shkak të një interpretimi formal nga vet AK të dokumentacionit të kërkuar. Si pasojë, na pamundësohet pjesëmarrja dhe konkurrimi i barabartë në këtë aktivitet të prokurimit, duke shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë material dhe duke kufizuar konkurrencën efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

2. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

- **Përgjigje në pretendimin nr. 4**

Lidhur me pretendimin nr. 4 – “Buxhet i pamjaftueshëm për realizimin e kërkesave sipas TeR”

Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim si tërësisht të pabazuar si në aspektin juridik ashtu edhe në aspektin faktik.

Fillimisht, AK sqaron se vlera e parashikuar e kontratës është përcaktuar në përputhje me nenin 56 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke u bazuar në:

analizën dhe hulumtimin e tregut;
natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve;
kontrata të ngjashme të realizuara më parë;
nevojat funksionale të projektit;
kohëzgjatjen e kontratës;
si dhe planifikimin buxhetor të Autoritetit Kontraktues.

AK thekson se legjislacioni i prokurimit publik nuk parasheh obligim ligjor që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë strukturën e kostove të operatorëve ekonomikë, nivelin e pagave të stafit të tyre apo modelin e organizimit të brendshëm ekonomik të secilit operator ekonomik.

Pretendimi i OE-së bazohet në kalkulime hipotetike dhe subjektive të hartuara nga vet operatori ekonomik, të cilat nuk mund të konsiderohen si standard objektiv dhe detyrues për Autoritetin Kontraktues.

Operatori ekonomik në pretendimin e tij paraqet një model të vetin të organizimit të stafit, mënyrës së angazhimit dhe strukturës së kostove operative, mirëpo kjo nuk do të thotë se i njëjti model është i vetmi model i mundshëm apo i detyrueshëm për realizimin e kontratës.

Në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe me nenin 7 të LPP-së, çdo operator ekonomik gëzon autonomi të plotë në:

organizimin e stafit;
mënyrën e angazhimit të ekspertëve;
shpërndarjen e detyrave;
strukturën e kostove;
si dhe menaxhimin e resurseve të veta njerëzore dhe financiare.

Autoriteti Kontraktues nuk mund dhe nuk duhet të ndërhyjë në mënyrën e organizimit të brendshëm ekonomik të operatorëve ekonomikë, për aq kohë sa ata respektojnë legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, përfshirë legjislacionin e punës, tatimeve dhe obligimeve sociale.

Po ashtu, pretendimi i OE-së lidhur me pagën minimale është i pabazuar, për faktin se AK nuk është punëdhënës i stafit të operatorëve ekonomikë dhe nuk përcakton marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësve të tij.

Obligimi për respektimin e legjislacionit të punës dhe pagesës minimale bie ekskluzivisht mbi operatorin ekonomik gjatë realizimit të kontratës.

Gjithashtu, pretendimi se angazhimet sipas TeR kërkojnë domosdoshmërisht angazhim të plotë ditor për secilin ekspert paraqet interpretim subjektiv të OE-së dhe jo kërkesë të shprehur në Dosjen e Tenderit apo në Termat e Referencës.

AK sqaron se Termat e Referencës përcaktojnë rezultatet dhe obligimet kontraktuale që duhet të realizohen, ndërsa mënyra konkrete e organizimit të ekipit dhe realizimit operacional mbetet kompetencë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik.

Sa i përket pretendimeve lidhur me lokacionet dhe frekuencën e vizitave në terren, AK vlerëson se këto janë elemente operative të realizimit të kontratës, të cilat menaxhohen nga vet operatorët ekonomikë në bazë të metodologjisë së tyre të punës, organizimit të ekipit dhe planifikimit operacional.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues thekson se vlera e parashikuar e kontratës nuk paraqet garanci të fitimit, marzhës së fitimit apo strukturës së kostove për operatorët ekonomikë, por paraqet vetëm vlerësim të përafërt të bazuar në analizë tregu dhe nevoja institucionale.

Çdo operator ekonomik mbetet i lirë:

të ofertojë ose jo;
të vlerësojë vetë fizibilitetin ekonomik të kontratës;
si dhe të përcaktojë çmimin ofertues në bazë të analizave të veta profesionale dhe ekonomike.

Për më tepër, fakti që një operator ekonomik konsideron subjektivisht se vlera e kontratës nuk është e favorshme ekonomikisht për modelin e tij të biznesit, nuk e bën automatikisht buxhetin e Autoritetit Kontraktues të kundërligjshëm apo joproporcional.

AK gjithashtu vlerëson se pretendimi i OE-së nuk është mbështetur në:

ekspertizë profesionale financiare;
analizë objektive të tregut;
krahasim me kontrata identike;
apo ndonjë provë konkrete që do të dëshmonte pamundësinë reale dhe objektive të realizimit të kontratës.

Në praktikën e prokurimit publik është e njohur se Autoriteti Kontraktues gëzon diskrecion të gjerë në përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës, për aq kohë sa e njëjta është përcaktuar mbi bazën e analizës së tregut dhe nevojave reale të institucionit dhe nuk është dëshmuar arbitraritet apo diskriminim.

Në rastin konkret, OE nuk ka arritur të dëshmojë se:

vlera e parashikuar është vendosur në kundërshtim me ligjin;
ekziston pamundësi objektive e realizimit të kontratës;
apo se kriteret e përcaktuara favorizojnë apo diskriminojnë operatorë të caktuar ekonomikë.

Përkundrazi, kërkesat e TeR dhe vlera e kontratës janë të zbatueshme dhe proporcionale me natyrën e shërbimeve të kërkuara.

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimi i OE-së është i pabazuar dhe si i tillë refuzohet në tërësi.

Në fund vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshilla juridike: Pala e pakënaqur, bazuar nën nenin 109 të këtij ligji mund të bëjë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës në afat prej 10 ditësh nga marrja e këtij vendimi.

Prishtinë 09.06.2026

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



| | |
|------------------------|--|
| DATË/A | 15.06.2026 |
| REFERENC-Ë | KRPP-DRR-15-06-90/2026 |
| PËR/ZATO: | OE- Studio Projektuse "LINKS 4" |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Z. Osman Vishaj, Kryetar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik |
| NGA/OD/FROM : | Arbnora Cakolli-Luzha, Drejtoare e Departamentit të Rregullave Qendrim Racaj Zyrtar Ligjor-Departamenti i Rregullave-KRPP |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje Kërkesës për Interpretim të datës 08.06.2026 |



Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP ofron sqarime si në vijim:

Përveç interpretimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, **KRPP nuk interpreton dhe/ose sqaron kriteret e përzgjedhjes të specifikuar nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.**

Hartimi i Dosjes së Tenderit është kërkesë e nenit 27 të LPP-së dhe nenit 17 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP).

Në përputhje me nenin 17.12 të RRPP-së, "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron **të gjitha informatat relevante** për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për

përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. **Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sgaruese shtesë...."**

Vendosja e kërkesave, kriteve, kushteve specifikimeve apo dëshmive në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues.

Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-së, **"Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji".**

Dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit dytësor kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues që kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ti specifikojnë në mënyrë të qartë jo diskriminuese dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik.

Për çdo paqartësi në lidhje me kriteret e përzgjedhjes të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, Operatorët Ekonomik në bazë të nenit 53 të LPP-së mund të kërkojë sqarime shtesë nga Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor të specifikuar në Dosje të Tenderit.

Ndërsa,

Në asnjë nga dispozitat 65-70 të LPP-së nuk përmendet **"Referenca"** në kuptim të dëshmisë që një OE ka kryer në mënyrë të kënaqshme një kontratë. Kjo mund të dëshmohet me **Raportin përfundimtar të kryerjes së punëve apo me Certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve** e cila si dëshmi përmendet në nenin 69 të LPP-së. Një Certifikatë e tillë kërkohet t'i lëshohet OE-së nga AK edhe sipas nenit 26 të Kushteve të përgjithshme të Kontratës - Pjesa B e Dosjes Standarde të Tenderit.

Pra, sa i përket "referencaave për realizim të kënaqshëm të kontratave", neni 26.7 dhe neni 26.8 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, përcaktojnë si në vijim:

"26.7 Referencat për kontratat e realizuara mund të dëshmohen me raportin përfundimtar të kryerjes së punëve apo me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve e cila si dëshmi përmendet në nenin 69 të LPP-së.

26.8 Në rast të furnizimeve, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë **përshtatshmërinë e produkteve** që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Një informatë se si grupi duhet t'i plotësojë kërkesat nga ky paragraf, duhet të vendoset në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Autoriteti Kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në ftesën për tenderim do të specifikojë se cilat referenca (dokumente) të saktësuara në këtë nen i nevojiten”.

Për më shumë, lidhur me çështjen për të cilën na keni shkruar, "**Lista e kontratave të realizuara (përfunduara)** ..."KRPP ka dhënë një Interpretim të cilin e ka publikuar në platformën e prokurimit datën 22.11.2022, në linkun: "**Informacione**" në vegzën "**INTERPRETIME**", Pyetja me numër 10.

Për të gjithë Operatorët Ekonomik që pretendojnë se kërkesat, kriteret, kushtet specifikimet apo dëshmitë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nuk janë vendosur në pajtim me legjislacionin e prokurimit, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).


Vërejtje: Interpretimi i dhënë nga KRPP, i referohet vetëm pyetjes së parashtruar nga ana juaj dhe assesi nuk i dedikohet aktivitetit të prokurimit.

Adresa: Ndërtesa e Gërmisë, zona B. Prishtinë, 10 000 Republika e Kosovës
krpp.rks-gov.net; **e-prokurimit.rks-gov.net** ; rregullat.krpp@rks-gov.net Tel: +381 038 213 709

10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FTD të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmive të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit

Titulli **Konfirmim i realizimit të kontratës**
Data e punimit: 03.04.2026
Nga: Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
Për: NNP Studio LINKS 4



Dokumentet Referuese: Development of the detailed energy audit reports, Detailed Designs, Technical Specifications including Supervision, Commissioning, and Management Supervision during Defects Liability Period, for Energy Efficient Building Renovations Contract No: KEEF/1C2.1/CQ/2020/LOT 1 date 30.12.2020 Nr. 436 dhe amendamenteve 1,2,3,4,5.ndërmjet N.N.P. Studio LINKS 4 dhe FKEE

Hyrje: Ky vërtetim pasqyron një përshkrim të detyrave të realizuara NNP Studiu LINKS 4 për kontratën në fjalë të nënshkruar me 30.12.2020 me një kohëzgjatje fillimisht deri më 30.12.2022 (me mundësi vazhdimi) e cila është vazhduar deri më 30.01.2026 dhe ka të bëjë me shërbime të konsulencës.

Projektet: NNP Studio LINKS 4 ka realizuar Auditimet e energjisë, dizajnin dhe ndihma teknike në kohën e tenderimit brenda kontratës në total për 21 ndërtesa, ndërsa për 19 ndërtesa është vazhduar me fazën e mbikëqyrjes dhe periudhën e garancionit, kurse 3 të tjera janë larguar nga ivestimi pas tenderimit, me kerkese të komunës.

Vlera fillestare e kontratës në fjalë në fillim ishte **244,849.92 €** kurse vlera finale për pagesë bazuar në ndryshimet kontraktuale është **270,686.90 €**. Detaje specifike janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Detyrat / Përbushja Bazuar në kushtet e kontratës, konfirmohet se kompania konsulente **NNP Studio LINKS 4** ka përbushur detyrat e përcaktuara në kuadër të kësaj kontrate, përfshirë:

- Detyra 1: Përfundimi i Raportit të Detajuar të Auditimit të Energjisë
- Detyra 2: Vlerësimi Seismik, Specifikimet Teknike dhe Projektet e Renovimit
- Detyra 2.1 Ri-dizajni i projekteve të renovimit dhe specifikimet teknike
- Detyra 3: Ndhma për KEEF në Përgatitjen e Kualifikimeve Teknike
- Detyra 4: Mbikëqyrja e Përfundimit dhe Pranimit/ Komisionimi i Punimeve të Ndërtimit
- Detyra 5: Menaxhimi dhe Mbikëqyrja gjatë Periudhës së Përgjegjësisë për Defekte (DLP)

Kompania Konsulente ka përbushur, në përputhje me kushtet kontraktuale, detyrat e sipërpërmendura (1-5) për 19 ndërtesa, duke përfshirë përgatitjen e raporteve të auditimit të energjisë, vlerësimet sizmike, hartimin e specifikimeve teknike dhe projekteve të renovimit, si dhe mbikëqyrjen dhe menaxhimin gjatë zbatimit dhe periudhës së përgjegjësisë për defekte. Ndërkohë, ri-dizajni i projekteve është realizuar për 13 projekte. Në këtë kuadër, konstatohet se shërbimet janë përfunduar në përputhje me kushtet kontraktuale.


Ky konfirmim pjesë të pa ndashme, ka kontraten dhe amendamentet.

AM

Tabela më poshtë pasqyron pagesat e kompanisë konsulente NNP Studio LINKS 4 në mënyrë specifike për secilin nga projektet.

| Nr. | Emri i ndërtesës | Komuna | Totali i paguar sipas kontratës dhe amandamenteve |
|-----|---|---------|---|
| 1 | SH.F.M.U "Ismail Qemali" | Istog | 14,072.02 € |
| 2 | Çerdhe "Pëllumbat e ardhmerisë" - Rakosh | Istog | 14,072.02 € |
| 3 | SH.F.M.U "Bajram Curri" - Dubravë | Istog | 14,072.02 € |
| 4 | I.A.A.P " Rifat Gjota" (ish "Shaban Spahija") | Pejë | 14,072.02 € |
| 5 | SH.F.M.U "Asdreni" - | Pejë | 14,072.02 € |
| 6 | SH.F.M.U "Ekrem Rexha", Lubizhdë | Prizren | 14,072.02 € |
| 7 | SH.F.M.U "Fadil Hisari" | Prizren | 14,072.02 € |
| 8 | SH.F.M.U "Mate Logoreci" | Prizren | 14,072.02 € |
| 9 | SH.F.M.U "12 Maji", fshati Ratkoc | Rahovec | 14,072.02 € |
| 10 | SH.F.M.U "Skender Kastrati", Gexhe | Rahovec | 14,072.02 € |
| 11 | SH.F.M.U "Avni Zhabota", Kerrnice | Klinë | 14,072.02 € |
| 12 | SH.F.M.U "3 Dëshmoret", Jashanice e Larte | Klinë | 14,072.02 € |
| 13 | SH.F.M.U "Fehmi Agani" | Gjakovë | 11,659.52 € |
| 14 | SH.F.M.U "Hamëz Thaqi", fshati Xerxe | Rahovec | 11,659.52 € |
| 15 | SH.F.M.U "Motrat Qiriazhi", Zajm | Klinë | 11,659.52 € |
| 16 | SH.F.M.U "Dëshmoret e Qendreses", Gilareve | Klinë | 11,659.52 € |
| 17 | SH.F.M.U "Mazllum Këpuska" | Gjakovë | 20,290.52 € |
| 18 | Pallati I Kulturës "Asim Vokshi" | Gjakovë | 17,404.78 € |
| 19 | Qendra kryesore e mjekësisë familjare Q.K.M.F-2 | Deçan | 5,829.76 € |
| 20 | Qendra kryesore e mjekësisë familjare Q.K.M.F | Istog | 5,829.76 € |
| 21 | Qendra e Mjekësisë Familjare Q.M.F-1 | Prizren | 5,829.76 € |
| | Total | | 270,686.90 € |

Menaxhere e Kontratës,
 Njomza Maraj



Drejtor i Departamentit të Operacioneve
 Petrit Ahmeti





FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Based on the request of the company [REDACTED], as a consulting company, in the project: "Development of detailed energy audit reports, detailed designs, technical specifications including supervision, commissioning and supervision of management during the defect liability period, for energy efficient building renovations and street lighting" with procurement number: KEEF/IC3/CQ/2020/LOT 1

Issues this:

REFERENCE

The company [REDACTED] has been contracted by the Kosovo Fund for Energy Efficiency to perform audit services, detailed design, technical specifications, supervision during the execution of works as well as supervision of the period of responsibility for defects for renovations with energy efficiency of buildings and street lighting.

Until today, when this reference is being issued, the company [REDACTED] has carried out energy audit reports, detailed technical projects, which are continuing with supervision in this ongoing contract.

The list of projects for which the aforementioned services were performed are:

- Primary school "Kadri Kusari"-Gjakove
- Palace of culture- Gjakove
- Primary school in Moznik-Deqan
- Primary and secondary lower school "Isa Boletini"-Rahovec
- Primary and secondary lower school "Bekim Sylka"-Rahovec
- Sports Hall-Malisheve
- Primary and secondary lower school "Ate Shtjefen Gjeqovi"-Kline
- Sports Hall in Drenas
- Kindergarden "Nena Zahide"-Skenderaj
- Center of culture "Hasan Prishtina"-Skenderaj
- Public lighting -Frashër-Mitrovice
- Public lighting -Malishevë
- Primary and secondary lower school "Migjeni"Baice-Drenas
- Primary and secondary lower school "Shaban Polluzha"Polluzhë-Drenas
- Primary and secondary lower school "Shotë Galica"-Abri e Epërme-Drenas
- Primary and secondary lower school "24 Korriku"-Fushtice e Poshtme-Drenas
- Family medicine clinic in Nekoc-Drenas

- Administration Facility in the Municipality of Mitrovica
- Family Medicine Center in Bajgora
- Family Medicine Center in Bare-Mitrovica
- Center of culture in Mitrovica
- Primary and secondary lower school "Skenderbeu"-Mitrovica

We are satisfied with the professionalism and dedication of [REDACTED] for completing the assigned tasks within the terms stipulated in the contract.

The total value of the project is: 244,030.74 €

And we, in any case, would not hesitate to recommend the Company "[REDACTED]" for similar management and professional services.


Kosovo Fund for Energy Efficiency

Data: 04.10.2022

